



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:084551

Datë: 25.03.2025

Numri i dokumentit: 07037532

C.nr.779/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtar Vegim Maloku, në çështjen juridiko-kontestuese të paditësve A. dhe M. K. që të dy nga Peja, të cilët i përfaqëson Ardit Ibraj avokat në Pejë, kundër të paditurës Votra – 1 Sh.P.K nga Peja, të cilën e përfaqëson Adrian Deçani nga Peja, rruga “Mbreti Pirro”, nga baza juridike: vërtetim pronësie, jashtë seance me datë 25.03.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësve: A. dhe M. K. që të dy nga Peja, kundër të paditurës Votra – 1 Sh.P.K nga Peja, me bazë juridike vërtetim pronësie e parashtruar pranë kësaj gjykate me datë 15.03.2024.

A r s y e t i m

Paditësit pranë kësaj gjykate me datë 15.03.2024, kanë parashtruar padi, kundër të paditurit, me bazë juridike: vërtetim pronësie.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë dhe provave prezentë në lëndë ka konstatuar se paditësit, padisë nuk i kanë bashkangjitur vërtetimin mbi taksën gjyqësor të paguar e që kërkohet në kuptim të dispozitë se nenit 253.4, të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësve, të autorizuarit të paditësve ju ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësorë me datë 26.02.2025, që të paguaj taksën gjyqësor për padi, në lartësi prej 20 euro, në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes, të cilën vërejtje i

autorizuari e paditësve e ka pranuar, me datë 27.02.2025, duke u njoftuar për pasojat e mos pagesës se taksës me arsyetim dhe në kuptim të dispozitave të cekura me lartë.

Sipas dispozitë se nenit 253.1, të LPK-së shprehimisht parashihet se çka duhet të përmbajë padia, sipas dispozitës se nenit 253.4, të këtij ligji, shprehimisht parashihet se paditësi ka për detyrë që padis ti bashkëngjit vërtetimin mbi taksën gjyqësor të paguar ndërsa sipas dispozitës së nenit 253.5 të këtij ligji, shprehimisht parashihet se në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padi e as pas vërejtjes se dërguar nga gjykata edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore do të konsiderohet se padia është e tërhequr.

Meqenëse palët paditëse nuk kanë vepruar në kuptim të vajtjes për pagesën e taksës gjyqësore për padi dhe gjykatës nuk i kanë dorëzuar kërkesë - prova që ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksisë gjyqësore për padi e duke u mbështetur në depozitat e nenit 253.1,4 dhe 5, dhe nenin 387.1, pika w), të LPK-së, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:084551, C.nr.779/24, 25.03.2025

Gj y q t a r i
Vegim Maloku

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate